



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 48 (827800)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 2 dhjetor 2022

Takimi i Ministrave të Mbrojtjes të Kartës së Adriatikut A-5

Ministrat e Mbrojtjes të Kartës së Adriatikut A - 5 (US - Adriatic Charter A-5) u takuan në Budva, Mali i Zi. Takimi u kryesua nga pala malazeze, si vendi drejtues i Kartës së Adriatikut - A5. Në të morën pjesë ministrat e Mbrojtjes dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga vendet anëtare, Shqipëria, Kroacia, Bosnje - Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe SHBA-të, si dhe në rolin e vendit vëzhgues, ministri i Mbrojtjes së Kosovës dhe përfaqësues të Sllovenisë dhe Serbisë. Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, për shkak të angazhimeve me rastin e 110 - vjetorit të Pavarësisë, u përfaqësua në takim nga z. Blerim Çaka, në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave të Mbrojtjes. Tematikat kryesore, ku u fokusua takimi, ishin mbi situatën aktuale dhe sfidat globale të sigurisë, me fokus të veçantë mbi zhvillimet në Ukrainë, pasojat e mundshme mbi sigurinë në rajon, adresimi i tyre në mënyrë kolektive, bashkëpunimi rajonal dhe angazhimet në mbështetje të paqes dhe stabilitetit në kuadër të A - 5, si dhe u dakordësuan mbi konceptin e Rivalizimit të Kartës së Adriatikut. Të gjithë të pranishmit dënuan njëzëri agresionin në Ukrainë, shprehën shqetësimin për situatën aktuale në kufirin lindor, ndikimi në rajonin tonë, si dhe shpalosën... >>> faqe 4

jtjes së Kosovës dhe përfaqësues të Sllovenisë dhe Serbisë. Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, për shkak të angazhimeve me rastin e 110 - vjetorit të Pavarësisë, u përfaqësua në takim nga z. Blerim Çaka, në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave të Mbrojtjes. Tematikat kryesore, ku u fokusua takimi, ishin mbi situatën aktuale dhe sfidat globale të sigurisë, me fokus të veçantë mbi zhvillimet në Ukrainë,

pasojat e mundshme mbi sigurinë në rajon, adresimi i tyre në mënyrë kolektive, bashkëpunimi rajonal dhe angazhimet në mbështetje të paqes dhe stabilitetit në kuadër të A - 5, si dhe u dakordësuan mbi konceptin e Rivalizimit të Kartës së Adriatikut. Të gjithë të pranishmit dënuan njëzëri agresionin në Ukrainë, shprehën shqetësimin për situatën aktuale në kufirin lindor, ndikimi në rajonin tonë, si dhe shpalosën... >>> faqe 4



110 vjet Pavarësi, 110 vjet FA, së bashku për Paqen

Ministri Niko Peleshi: Mesazhe paqeje dhe sigurie përmes muzikës, si gjuha që bashkon gjithë kombet



>>> faqe 3

FA dhe FSK, bashkë në 110 vjet Shtet Shqiptar

Djemtë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe ata të Forcave të Sigurisë së Kosovës, së bashku në Kukës, në qytetin simbol të mikpritjes në një kohë të vështirë lufte. Momenti i veçantë, jo vetëm për të festuar 110 - vjetorin e Pavarësisë dhe krijimit të Forcave të Armatosura, por për të forcuar më tej bashkëpunimin ushtarak...



>>> Faqe 2

Ministri Peleshi: Nuk ka rrugë tjetër përveçse të bëhemi të gjithë bashkë në anën e lirisë, të evokojmë paqen

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në ceremoninë e organizuar me rastin e 78 - vjetorit të Çlirimit të vendit, në qytetin e Korçës. Ministri Peleshi vendosi një kurorë me lule në Varrezat e Dëshmorëve të qytetit, për të shprehur mirënjohjen për sakrificën e tyre. Pjesë e ceremonisë ishin prefekti i qarkut, kryetarët e bashkive, deputetë të qarkut, veteranë si edhe familjarë të dëshmorëve. Për mediat, ministri Peleshi u shpreh se: "Sot jetojmë në kohën kur paqja dhe siguria janë cenuar dhe përgjigja..."



>>> Faqe 3

Gjeneralmajor Shehu: Memorial i veprës së gjeneralmajor Thoma Xhixhos, një trashëgimi e vyer për ushtarakët

Në kuadër të 20-vjetorit të ndarjes nga jeta të gjeneralmajorit Thoma Xhixho, si dhe promovimit të librit kushtuar jetës dhe veprës së tij, u organizua një ceremoni me pjesëmarrjen e zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, ish-presidentit të Shqipërisë z. Alfred Moisiu, z. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, z. Porodini, kryetar i Komitetit të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, gjeneral brigade Bilbil Bitri...



>>> Faqe 10-11



Djemtë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe ata të Forcave të Sigurisë së Kosovës, së bashku në Kukës, në qytetin simbol të mikpritjes në një kohë të vështirë luftar. Moment i veçantë, jo vetëm për të festuar 110 - vjetorin e Pavarësisë dhe krijimit të Forcave të Armatosura, por për të forcuar më tej bashkëpunimin ushtarak, edhe përmes muzikës dhe sportit.

FA dhe FSK, bashkë në 110 vjet Shtet Shqiptar



Përfundon stërvitja dypalëshe “Strong Eagle-5”, e Forcave Speciale të ROS me ushtarakët britanikë



Forca Tokësore rrit kontributin e saj në kuadër të paqes dhe sigurisë, me nisjen e kontingjentit të parë si pjesë e operacionit “Aktiviteti i vigjilencës së përforcuar”, e drejtuar nga NATO në Bullgari. 30 efektivë të batalionit të Parë të Këmbëorisë (b1k) do të bashkohen me trupat aleate në Novo Selo, Bullgari, ku do të shërbejnë për një periudhë rreth 6-mujore.



110 VJET PAVARËSI, 110 VJET FORCA TË ARMATOSURA, SË BASHKU PËR PAQEN

Ministri Peleshi: Mesazhe paqeje dhe sigurie përmes muzikës, si gjuha që bashkon gjithë kombet

Bandat ushtarake të Shqipërisë, SHBA-së dhe Britanisë së Madhe u bënë bashkë për herë të parë, në qytetin e Korçës, me rastin e festimeve të 110 - vjetorit të Pavarësisë dhe 110 - vjetorit të krijimit të Forcave të Armatosura.

Qytetarë të shumtë, jo vetëm nga Korça, por edhe qytetet e ndryshme të vendit shijuan një mbrëmje të bukur festive, që filloi tek zona këmbësore dhe vijoi tek Pazar i Vjetër. I pranishëm ishte edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili tha se: “Bashkimi i bandave të vendeve të NATO-s dhe Kosovës në këto aktivitete që përkujtojnë edhe me 110 - vjetorin e Pavarësisë dhe me 110 - vjetorin e krijimit të Forcave të Armatosura kërkon të përcjellë një mesazh të bukur paqeje dhe sigurie”.

Aktivitete të tjera pati dhe në qytetin e Kukësit ku Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Forcat e Sigurisë së Kosovës zhvilluan një ndeshje futbolli, ndërsa performuan në një koncert të përbashkët.

Në pika të ndryshme të kryeqytetit po organizohen performanca të ndryshme, të bandave ushtarake të Sllovenisë, Italisë, Maqedonisë së Veriut, Britanisë së Madhe, Greqisë, Kosovës, SHBA-së, Francës dhe Shqipërisë.

Aktiviteti i tyre do të përmbyllet në koncertin e madh festiv, organizuar nga Ministria e Mbrojtjes, në Pallatin e Kongreseve.



78 - VJETORI I ÇLIRIMIT TË VENDIT, PELESHI HOMAZHE NË KORÇË

Ministri Peleshi: Nuk ka rrugë tjetër përveçse të bëhemi të gjithë bashkë në anën e lirisë, të evokojmë paqen

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në ceremoninë e organizuar me rastin e 78 - vjetorit të Çlirimit të vendit, në qytetin e Korçës. Ministri Peleshi vendosi një kurorë me lule në Varrezat e Dëshmorëve të qytetit, për të shprehur mirënjohjen për sakrificën e tyre.

Pjesë e ceremonisë ishin prefekti i qarkut, kryetarët e bashkive, deputetë të qarkut, veteranë si edhe familjarë të dëshmorëve.

Për mediat, ministri Peleshi u shpreh se: “Sot jetojmë në kohën kur paqja dhe siguria janë cenuar dhe përgjigja më e mirë e Aleancës sonë, që qëndron në anën e lirisë, është solidariteti dhe bashkëpunimi.

“Nuk ka rrugë tjetër përveçse të bëhemi të gjithë bashkë në anën e lirisë, kundër agresionit, të evokojmë paqen. Sot këtu është dita. Këtu prehen dëshmorët e këtij qarku, që u ka dhënë jo pak përpjekjeve për liri e pavarësi. Jam këtu si Ministër i Mbrojtjes, sepse duam të tregojmë se i gjithë populli shqiptar ishte në



anën e së mirës, ishte në anën e lirisë dhe paqes dhe kjo na jep ne të drejtë, edhe historike, për të kërkuar të jemi

plotësisht të integruar. “Jemi në NATO, por duam të integrohemi plotësisht edhe në BE”, - u shpreh ministri Peleshi.



Shefi i Shtabit të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim zyrtar delegacionin estonez, të përfaqësuar nga gjenerallejtënant Martin Herem

Shefi i Shtabit të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim zyrtar delegacionin estonez, të përfaqësuar nga gjenerallejtënant Martin Herem, ku u diskutua mbi sfidat e sigurisë rajonale, krijimin e kapaciteteve të reja të mbrojtjes kibernetike, si dhe mundësitë për të rritur bashkëpunimin dypalësh ushtarak ndërmjet Shqipërisë dhe Estonisë. Në vizitën e tyre të parë në Shqipëri, delegacioni pati rastin të ndjekë nga afër demonstrimin e përgatitjes nga Regjimenti i Operacioneve Speciale.



Takimi i Ministrave të Mbrojtjes së Kartës së Adriatikut A-5

Ministrat e Mbrojtjes së Kartës së Adriatikut A - 5 (US - Adriatic Charter A-5) u takuan në Budva, Mali i Zi. Takimi u kryesua nga pala malazeze, si vendi drejtues i Kartës së Adriatikut - A5.

Në të morën pjesë ministrat e Mbrojtjes dhe përfaqësues të nivelit të lartë nga vendet anëtare, Shqipëria, Kroacia, Bosnje - Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe SHBA-të, si dhe në rolin e vendit vëzhgues, ministri i Mbrojtjes së Kosovës dhe përfaqësues të Sllovenisë dhe Serbisë. Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, për shkak të angazhimeve me rastin e 110 - vjetorit të Pavarësisë, u përfaqësua në takim nga z. Blerim Çaka, në funksionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Politikave të Mbrojtjes.

Tematikat kryesore, ku u fokusua takimi, ishin mbi situatën aktuale dhe sfidat globale të sigurisë, me fokus të veçantë mbi zhvillimet në Ukrainë, pasojat e mundshme mbi sigurinë në rajon, adresimi i tyre në mënyrë kolektive, bashkëpunimi rajonal dhe angazhimet në mbështetje të paqes dhe stabilitetit në kuadër të A - 5, si dhe u dakordësuan mbi konceptin e Rivitalizimit të Kartës së Adriatikut.

Të gjithë të pranishmit dënuan njëzëri agresionin në Ukrainë, shprehën shqetësimin për situatën aktuale në kufirin lindor, ndikimi në rajonin tonë, si dhe shpalosën vendosmërinë për një mbështetje të mëtejshme materiale dhe humanitare për garantimin e lirisë dhe sovranitetit të vendit.

Nga të gjithë vendet anëtare u theksua fakti që Karta e Adriatikut ka luajtur dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në procesin e integritetit të vendeve të rajonit në NATO dhe në Bashkimin Europian, si rruga kryesore për garantimin e sigurisë dhe paqes në rajon. Nga të pranishmit u vlerësua marrja e statusit kandidat për anëtarësimin në Bashkimin Europian të Bosnje - Hercegovinës. Në të njëjtën



kohë iu bë thirrje instancave të BE-së për të ruajtur ritmin dhe integritet plotë europian të të gjitha vendeve të

Ballkanit Perëndimor, për të shmangur ndikime të mundshme nga vende si Rusia apo Kina.

Përfaqësuesi i vendit tonë, duke mbështetur fuqishëm politikën e dyerve të hapura, kërkoi anëtarësimin

e Kosovës në Kartën e Adriatikut, duke arritur një vendim konkret nga të gjithë anëtarët dhe vlerësuar kërkesën e bërë prej kohësh.

Përfaqësuesi i Lartë i palës amerikane, znj. Celeste Wallander, asistente e Sekretarit të Mbrojtjes për Çështjet Ndërkombëtare të Sigurisë, ndër të tjera shprehu mbështetjen e vazhdueshme të SHBA-së në përballien me sfidat e sigurisë dhe, në të njëjtën kohë, theksoi rolin e veçantë të Kartës së Adriatikut në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe përballien me sfidat aktuale të sigurisë, sidomos me angazhime në kuadër të Mbrojtjes Kibernetike dhe veprimeve ushtarake të Rusisë në Ukrainë.

Në fund të takimit u firmos deklarata e përbashkët.



Duhet të jesh Shqiptar, ta kuptosh

Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

Një ditë, një djalë i ri ishte duke gjuajtur nëpër male, një shqiponjë fluturoi mbi të duke rrahur fort krahët dhe ndaloi në një shkëmb.

Shqiponja ishte shumë e madhe dhe mbante një gjarpër në sqepin e saj. Pas pak, shqiponja fluturoi mbi shkëmb dhe ndaloi aty ku kishte folenë e saj. Djaloshi i ri kërcëu mbi shkëmb dhe vuri re se në folë ishte një shqiponjëz e vogël që po luante me gjarprin e ngordhur. Por zvarraniku grabitqar nuk ishte i ngordhur. Në atë çast gjarpri ngre kokën dhe u pozicionua gati për të pickuar shqiponjëzën e vogël me dhëmbët e tij helmues. Djaloshi nxori në çast harkun dhe shigjetën dhe qëllon mbi gjarprin për vdekje. Më pas e mori shqiponjëzën dhe mori rrugën e kthimit. Kur s' kish bërë veçse disa hapa, dëgjon mbi kokën e tij një zhurmë të fortë përplasje krahësh, ishte shqiponja mëmë.

- Përse po më rrëmben foshnjën time? - iu qa shqiponja.

- Shqiponjëza tani është imja, pasi unë i shpëtova jetën, duke vrarë gjarprin që donte ta pickonte, kafshën, që ti nuk e vrave dot vetë, iu përgjigj djaloshi.

- Më kthe zogthin tim dhe unë do të të jap si këmbim mprehtësinë e syve të mi dhe forcën e krahëve të mi. Do të bëhesh i fortë dhe i pathyeshëm dhe do të njihesh me emrin tim.

Djaloshi u bind dhe ia ktheu zogthin mëmë. Kur shqiponjëza u rrit dhe nisi të fluturonte, shihej gjithnjë të fluturonte në qiell, diku mbi kokën e djaloshtit, kudo që ai shkonte, djaloshi u rrit dhe u bë burrë, u bë një gjuetar dhe luftëtar i madh. Ku kalonte, afër ndonjë vendi të banuar me njerëz dridhej toka nga frika e njerëzve kundrejt njeriut me shqiponjë. U bë një



prijës i mençur dhe i urtë, çdo vend kërkonte urtësinë e tij. Me harkun dhe shigjetat e tij ai vrau shumë grabitqarë nëpër pyje dhe me shpatën e tij u preu kokat shumë kundërshtarëve dashakeqës.

Të mrekulluar nga bëmat e djaloshtit gjuetar e luftëtar, banorët e atyre anëve e

zgjodhën atë, prijësin e tyre dhe e quajtën Shqiptar ose bir i shqipes, dhe trojet ku banonin i quajtën Shqipëri ose Vendi i Shqiponjave.

Përgjatë tërë këtyre viteve, shqiponja e shoqëroi djaloshtin dhe e udhëhoqi pa iu ndarë as edhe një çast.

Ata ishin të pandashëm, një trup me dy koka

Dhe bijtë e shqipes rriten e trimërohen, me forcën e shqipes me dy krerë, me dashurinë e saj për folenë. Flamuri Shqiptar ashtu si dhe gjuha e tij kanë karakter kozmik andaj ai duket se është po aq i vjetër sa dhe vet ndërgjegjja njerëzore. Gjithashtu i gjen të mishëruara brenda simbolit të tij të gjitha etapat historike në të cilat ka kaluar gjaku i shqiptarëve nëpër mijëvjeçarë dhe peripecitë e civilizimit të vet nëpër rrugëtimin e vështirë drejt së ardhmes europiane.

Mbi flamurin shqiptar padyshim në gjatësinë e shekujve është folur, shkruar dhe komentuar mjaft. Ky simbol është shenja më kuptimplotë si dëshmitari i përgjeshëm i origjinës tonë. Historia e tij është krejt e veçantë, siç është e veçantë dhe historia e popullit tonë.

Sa i hershëm duhet të jetë ky simbol?

Po populli shqiptar, sa i hershëm është?

Ai përfaqëson gjithashtu në mënyrë të sintetizuar filozofinë, kulturën, traditën dhe eksperiencën e epokave të ndryshme, dëshmitar i momenteve pozitive dhe negative.

Dëshmitar i dorës së parë në sukseset dhe dështimet tona.

Flamuri i Bijve të Shqipes, nëpër-

mjet tij zbulojmë origjinën tonë nga vijnë dhe që në mënyrë të dukshme na shtyn sot të vazhdojmë të ruajmë lidhjet tona shpirtërore.

Bijtë e Shqipes, filozofia e jetës së tyre s'ka dyshim që gjendet e pasqyruar në librat e shenjtë, në shpella, në gurët e varreve, në shkollat dhe universitetet.

Ata lanë gjurmë kudo ku shkelën, duke kaluar dhe jetuar.

Ata ishin mjeshtër ndërtime, njerëz me kurajë të veçantë, optimistë të pandreqshëm dhe mësues të mëdhenj po ashtu.

Luftëtarë të rreptë që askush nuk ua pa shpinën. Gjuha e tyre ishte gjuha e Zotit.

Kishte të drejtë profeti Nostradamus 1503-1566, kur predikonte për ne: "Shqiptarët ende nuk i kanë luajtur të gjitha kartat e tyre dhe se padyshim ata përsëri do ta habisin gjithë botën në arenën ndërkombëtare."

Iirët ishin popullsia e parë dhe origjinale e Europës me vlera të padiskutuara në fushën e dijes e teknologjisë.

Shqiponja dykrenore është simbol i idealit dhe frymës bashkuese shqiptare të mbretërisë së uzurpuar nga raca aziatike, greke e më vonë edhe e barbarizmës së ardhur sllave, pas rrënimit kataklizmik të Dardanisë.

Qielli dhe toka po marrin ngjyrat kuq e zi e me mijëra këto ditë po marshojnë qëllimshëm drejtë historisë. Dhe unë do doja të jem diku lart... ja pikërisht atje në qiellin e hapur, lart, po aty ku fluturon ajo Shqiponjë... që të ta përshkruaj si frymon Shqiptaria këto ditë, në mënyrë që Ti vogëlushi i sotëm dhe burri i shtetit të këtij kombi ta lexosh, pasi tani kemi shkuar në 110-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë... imazh i madhërisë... ndjenja të përziera..! Flamuri kuq e zi valon gjithandej dhe po, kur e shikon të stërbush nga brenda, të drejton shtatin dhe krenaria fillon të fluturojë. Dhe po, pikërisht ky Flamuri i zbuluar nga albanologët, Flamuri i Skendërbeut valëvitet gjithandej, ku ka sot shqiptarë. Ishte ky Flamur që valëvitet edhe shekujve të robërisë, duke i dhënë dritë shpresës për liri dhe ja, po i këndojmë, 110 vite të lirë në hisen e tokës që na takon.

Duhet të jesh Shqiptar ta kuptosh këtë lidhje, sepse është e vështirë për ta përshkruar.

Paramendoje sikur je duke fluturuar mbi një shqiponjë të zezë, shtigjeve të përgjakura të lirisë, duke mbledhur lule të kuqe, të cilat i shtrëngon aq fort sa që gjithçka brenda teje ulërin.

Dikush më pyeti: Po çfarë simbolizon Flamuri i kuq, që në mes ka shqiponjën dykrerëshe?

Dhe unë i thashë: Më fal... nuk përshkruhet... përjetohet.



Gjeneralmajor Shehu: Ky memorial i veprës së lavdishme të gjeneralmajor Thoma Xhixhos, të shërbejë në rrugëtimin e ushtarakëve të sotëm dhe brezave të rinj si një trashëgimi e vyer

Në kuadër të 20-vjetorit të ndarjes nga jeta të gjeneralmajorit Thoma Xhixho, si dhe promovimit të librit kushtuar jetës dhe veprës së tij, u organizua një ceremoni me pjesëmarrjen e zëvendëssefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, ish-presidentit të Shqipërisë z. Alfred Moisiu,

z. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, z. Porodini, kryetar i Komitetit të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, gjeneral brigade Bilbil Bitri, komandant i Akademisë së FA-së, familjarë e të afërm të gjeneralmajor Thoma Xhixhos.

Në fjalën e saj, gjeneralmajor Manushaqe Shehu mes të tjerash do shprehte: Gjeneral Xhixho i përket atij brezi të artë patriotësh shqiptarë, të cilët iu bashkuan lëvizjes nacionalçlirimtare që në hapat e para dhe dhanë kontribut të rëndësishëm në çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Vëllai i tij, Pano Xhixho dha jetën në këtë luftë dhe sot prehet në varrezat e “Dëshmorëve të Atdheut”.

Ai e filloi karrierën e tij të luftës, si luftëtar i thjeshtë, si antifashist i tërbuar e si atdhetar i flaktë qysh në vitet e adoleshencës, për të vazhduar në atë të komandantit të kompanisë, batalionit partizan e deri në detyrën e komisarit të Brigadës së 9-të Sulmuese. Në të gjitha betejat luftarake, që mori pjesë, tregoi aftësitë e tij të padiskutueshme të një lidhësi ushtarak.

Gjeneral Thoma Xhixho ishte shembulli i një ushtaraku të mirëfilltë, i një profesionisti të shkëlqyer, i një shkencëtar ushtarak të kohës, autor e bashkautor i shumë dokumenteve të rëndësishme të mbrojtjes dhe i shtypit shkencor ushtarak.

Për kontributin e tij në luftë dhe në shërbim të Forcave të Armatosura, gjeneral Xhixho me meritë arriti të marrë gradën madhore, atë të “gjeneralmajorit”, si dhe një sërë urdhrash e medaljesh nga institucionet më të larta të vendit, të cilat ia zbuluronin e hijeshonin gjoksin e tij.

Përveçse një ushtarak i zoti e i rrallë, gjenerali ishte një bashkëshort i denjë për Sofikën, një prind dhe baba shembullor i 2 djemve, Piros dhe Sokolit dhe një gjysh i shkëlqyer i nipërve dhe mbesave të tij.

Gjeneral Xhixho, edhe pse në



vitin 1977 doli në pension, aktivitetin e tij shkencor e shoqëror nuk e ndërpreu për asnjë çast, deri sa u nda nga jeta në vitin 2002, duke lënë prapa një histori të lavdishme, shembull frymëzimi për brezat e rinj, sidomos për ushtarakët.

Të flasësh për jetën dhe aktivitetin e një gjenerali duhen orë e ditë të tëra, por jeta e gjeneral Xhixhos është përmbledhur fare mirë në këtë libër nga historiani ushtarak, kolegu im, profesor Bernard

Zotaj, i cili po bën një punë të shkëlqyer në evidentimin dhe ruajtjen e traditave të popullit tonë, të luftës nacionalçlirimtare, të vlerësimit të figurave të shquara të kombit tonë, njëri prej të cilëve është edhe kjo figurë e nderuar e gjeneral Xhixhos, trajtuar nga profesori në mënyrë aq të përsosur në këtë libër, i cili me siguri do të lerë gjurmë te lexuesi në tërësi e në veçanti te ai ushtarak.

Autori me aftësitë e tij të spikatura

prej studiuesi e historiani, me dokumentacionin e fotot e vëna në dispozicion nga familja, nga gërmimet e bëra në arkivat e shtetit e të Forcave të Armatosura, nga kujtimet e vlerësimet e dhëna nga bashkëpunëtorët dhe bashkëkohësit e tij, nga miqtë, shokët, të afërmit, kolegët, ka ditur t'i trajtojë aq bukur në këtë libër, shkruar me një gjuhë të pastër e të bukur, që shton oreksin për ta lexuar, duke e bërë këtë libër me vlera historike, shkencore,

TË FLASËSH PËR JETËN DHE AKTIVITETIN E NJË GJENERALI DUHEN ORË E DITË TË TËRA, POR JETA E GJENERAL XHIXHOS ËSHTË PËRMBLEDHUR FARE MIRË NË KËTË LIBËR NGA HISTORIANI USHTARAK, KOLEGU IM, PROFESOR BERNARD ZOTAJ, I CILI PO BËN NJË PUNË TË SHKËLQYER NË EVIDENTIMIN DHE RUAJTJEN E TRADITAVE TË POPULLIT TONË, TË LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE, TË VLERËSIMIT TË FIGURAVE TË SHQUARA TË KOMBIT TONË, NJËRI PREJ TË CILËVE ËSHTË EDHE KJO FIGURË E NDERUAR E GJENERAL XHIXHOS, TRAJTUAR NGA PROFESORI NË MËNYRË AQ TË PËRSOSUR NË KËTË LIBËR, I CILI ME SIGURI DO TË LERË GJURMË TE LEXUESI NË TËRËSI E NË VEÇANTI TE AI USHTARAK.

artistike e familjare, duke e nxjerrë figurën e gjeneralit të plotë si ushtarak të formuar, si drejtues të aftë, si veteran e aktivist shoqëror. Ky libër me siguri do të jetë një dhuratë e çmuar për Forcat e Armatosura, krahinë e Lunxhërisë.

Ky libër i botuar në kujtim të 20-vjetorit të ndarjes nga jeta të gjeneral Xhixhos, le të jetë edhe si një homazh dhe një memorial i veprës së tij të lavdishme, të cilën ne ushtarakët e sotëm duhet ta ndjekim dhe t'ua transmetojmë brezave të rinj si një trashëgimi të vyer.

Ju bijtë e Tij, nipër e mbesa, vendlindja Gjirokastra, por edhe ne Forcat e Armatosura, duhet të ndihemi krenar për këtë figurë të rëndësishme, ushtarake, shoqërore dhe njerëzore, që bëri emër në histori, ashtu siç duhet të jemi krenarë e të përulemi përpara të gjithë njerëzve të kësaj kategorie, që janë pjesë e memories historike të kombit tonë.

Vlerësim e respekt për të gjithë plejadën e ushtarakëve e veteranëve shqiptarë që sakrifikan e bënë gjithçka në mbrojtje të interesave të larta të atdheut tonë të dashur.

“Gjeneral Xhixho i përket atij brezi të artë patriotësh shqiptarë, të cilët iu bashkuan lëvizjes nacionalçlirimtare që në hapat e para dhe dhanë kontribut të rëndësishëm në çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Vëllai i tij, Pano Xhixho dha jetën në këtë luftë dhe sot prehet në varrezat e “Dëshmorëve të Atdheut”.

(Në kuadrin e 20-vjetorit të ndarjes nga jeta)

Gjeneral Thoma Xhixho, i pari komandant i Akademisë Ushtarake Shqiptare



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

U formua në ambientin patriotik shqiptar

Thoma Koço Xhixho ishte komandant i arsimit ushtarak shqiptar, drejtues i përgatitjes luftarake dhe njeri i mirë. Nisur nga ky mendim, shpresoj që tërë jetën e tij të paraqitur në këtë monografi, ta shtjelloj duke përdorur fakte të thjeshta dhe mendimin teorik e praktik. Me jetën dhe veprën e gjeneral Thoma Xhixhos jam njohur në vitin 2008, kur përgatitëm librin “50 vjet Akademi e Mbrojtjes” dhe në vitin 2018, kur në gazetën “Ushtria” botova shkrimin “Thoma Xhixho, personalitet i shquar i arsimit dhe i shkencës ushtarake”, në kuadrin e 60-vjetorit të krijimit të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA).

Shkrimi për personalitete të larta të vendit është nder, por dhe përgjegjësi, siç është edhe figura e gjeneralit Thoma Xhixho, i cili ishte patriot dhe ushtarak i lartë, ai ka luftuar, punuar dhe kontribuar në kohë historike për ngritjen dhe lartësimin e ushtrisë shqiptare. Ka qenë koha dhe momenti historik, që prunë në skenë lëvizjen dhe Luftën legjendare Antifashiste, e cila afirmoi dhe nxori në dukje mjaft patriotë e luftëtarë, midis të cilëve edhe Thoma Xhixhon, komandant e komisar i njëjve sulmuese partizane. Sigurisht, Thomai ishte formuar me ndjenja patriotike që në rininë e tij, në ambientin patriotik shqiptar, në Suhë, fshati i lindjes, në gjirin e familjes patriote Xhixho. Ai u edukua me frymën atdhetare, që e përcollën në shekuj burrat dhe luftëtarët e hershëm të fshatit, të krahinës dhe të Gjirokastrës.

Nga studimi i historisë së karrierës dhe të kontributit atdhetar të gjeneral Thomait, të këtij antifashisti dhe luftëtar, ndien krenari për këtë figurë ushtarake dhe patriot që gjithë jetën qëndroi ushtar i atdheut. Ai vjen nga fisi i njohur Xhixho në Suhë të Gjirokastrës, një fshat i vogël i Shqipërisë së Jugut, në krahinën e Lunxhërisë, e njohur për me histori e tradita luftarake, me kapedanë e luftëtarë të shquar, burra të mençur e të zotë dhe gra luftëtare të gjendura në krah të burrave, njerëz këmbëngulës e kurajozë, me një botë të gjerë shpirtërore, me zakone e tradita të spikatura.

Me kontribute të vlerësuara në qarkun e Gjirokastrës

Fisnikëria e këtij fisi doli jashtë hapësirave të Suhës dhe u shqua e dha kontribut të dukshëm gjatë LANÇ-it, ku komisar i batalionit “Misto Mame”, dhe më vonë komisar i batalionit të tretë të



Brigadës VIII S, Pano Xhixho, vëllai i Thomait, luftoi dhe ra dëshmor për lirinë e atdheut, në Vishegrad të Jugosllavisë (sot Republika e Bosnjë-Hercegovinës). Nga ky fis doli Thoma Xhixho, që u bë i njohur në hapësirën shqiptare, në fushën e artit e shkencës ushtarake, si dhe të përgatitjes luftarake të ushtrisë. Ai, si ushtarak i lartë, duke përligjur virtytet morale, i ka ngjitur shkallët e gradimeve ushtarake deri në “gjeneralmajor”, si dhe është vlerësuar në jetë dhe është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me urdhra e medalje të ndryshme. Shkolla e mesme, që Thoma Xhixho mbaroi në Gjirokastër, kurset përgatitore në Itali, akademitë ushtarake në BS, kalitën disiplinën ushtarake, karakterin burrëror dhe moralin e lartë atdhetar.

Thomai, në fillimet e Lëvizjes, luftoi si pjesëmarrës aktiv. Në vitet 1942-1944, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) për çlirim e Shqipërisë, Thoma Xhixho dha një kontribut të vlerësuar në qarkun e Gjirokastrës për organizimin dhe drejtimin e formacioneve ushtarake partizane, në detyrën e drejtuesit të komandës së vendit, por dhe të komisarit e të komandantit të njëjve partizane si kompani, batalion dhe brigadë. Ai arriti të bëhet komisar i Batalionit “Telo Plaku”, më vonë komisar i batalionit “Thoma Lula”, si dhe në fund, komisar i Brigadës XIX Sulmuese. Luftimet dhe betejat e zhvilluara gjatë LANÇ-it, e bënë Thomain dëshmitar dhe protagonist

aktiv në shumë ngjarje e zhvillime kryesore të saj. Në Kongresin e Përmetit atij iu akordua grada e lartë për kohën, “major”.

Punoi me shpirt për organizimin e ushtrisë shqiptare

Mbas çlirimit, në kushtet e një ushtrie të dalë nga lufta, ushtarakët shqiptarë iu përveshën punës për të ndërtuar, organizuar e përgatitur ushtrinë shqiptare, duke dhënë maksimumin e tyre. Ata i shërbyen atdheut në çdo kohë si mbështetës të lirisë, të pavarësisë dhe në ruajtjen e mbrojtjen e kufijve territorialë të saj.

Në vitin 1945, menjëherë mbas çlirimit, Thomai u dërgua për studime në Akademinë “Frunze” në BS, dhe pas kthimit në atdhe, me fillimet e organizimit të ushtrisë shqiptare, mbajti mbi supë mjaft funksione drejtuese ushtarake në repartet e njësitë e kësaj ushtrie si, shef shtabi divizioni në Tiranë, në Korçë dhe në Gjirokastër, në vitet 1947-1950. Me riorganizimin e ushtrisë, në detyrën e komandantit, ka drejtuar Brigadat e Këmbësorisë në Burrel, gjatë viteve 1950-1952, dhe në Gjirokastër gjatë viteve 1954-1958.

Gjeneral Thomai ka shërbyer si ushtarak karriere i ushtrisë shqiptare, duke punuar e luftuar në mbrojtje të lirisë e të pavarësisë së atdheut, të forcimit të ushtrisë kombëtare, si dhe të arsimit dhe të shkencës ushtarake shqiptare. Karriera e Thomait është e lidhur në mënyrë të pazgjidhur me historinë e ushtrisë

kombëtare, me artin e saj ushtarak, të cilin e mësoi në shkolla, në kurse kualifikimi, në akademi, por dhe në luftëra e beteja, në momente historike që në hapat e parë të karrierës së tij. Më tej, ai dha kontributin themeltar në studimin shkencor dhe përsosjen e tij. Thomai u bë mësues, edukues dhe akademik i rëndësishëm i shkollave tona ushtarake. Komandant i dalë nga lufta popullore, shkencëtar ushtarak si i katedrës ashtu dhe i terrenit, mishërues i instruksionit të qartë e praktik, ai përçoi me pasion, efektshmëri e dashuri artin ushtarak popullor në breza. Gjeneral Thomai kaloi 15 vjet të jetës së tij ushtarake i lidhur me shkollat ushtarake. Për rreth tre vjet, 1952-1954, ishte komandant i Shkollës së Bashkuar të Oficerëve.

Thomai merr gradën e merituar “gjeneralmajor”

Në vitin 1958, Thomai me gradën kolonel, me vendim të Byrosë Politike të PPSH-së dhe urdhrin e ministrit të Mbrojtjes, u ngarkua të formonte Shkollën e Lartë Ushtarake. Kjo shkollë, në vitin 1961 u emërtua Akademia Ushtarake, ku përsëri gjeneral Thomai u emërua komandant i parë i saj. Në këtë detyrë ai qëndroi deri në mars të vitit 1966. Në vitin 1961 ndoqi studimet në Akademinë “Voroshilov” dhe pas kthimit nga Moska, emërohet përsëri komandant i Akademisë.

Shkollën e Lartë Ushtarake e ngritën nga e para, me përpjekje dhe përkushtim të madh të Thoma Xhixhos dhe një stafi oficerësh të lartë. Ky ishte një nga kontributet më të rëndësishme edhe për forcimin e arsimit ushtarak, por edhe për karrierën e tij. Në vitin 1963 Thoma Xhixho gradohet “gjeneralmajor”. Në librin e tij gjeneralmajori rus me origjinë shqiptare, Jani Lufi është shprehur: “Thomai merr gradën e merituar ‘gjeneralmajor’”.

Nga viti 1972 deri sa doli në pension, në vitin 1977, gjeneral Thomai punoi përsëri në Akademi si zëvendëskomandant dhe drejtues i degës shkencore të sapokrijuar. Pas daljes në pension me porosi të ministrit të Mbrojtjes, Mehmet Shehu, gjeneral Thomai së bashku me gjeneral Vehbi Hoxhën dhe kolonel Moisi Elezin u angazhuan deri në fund të vitit 1981 pranë Akademisë Ushtarake, si këshilltarë të jashtëm, duke dhënë ndihmesë me përvojën e tyre të madhe në struktura ushtarake dhe shkencore të Ushtrisë Popullore. Rreth 800 ushtarakë janë diplomuar në Akademinë Ushtarake në periudhat kur gjeneral Thomai ishte drejtues i këtij institucioni. Vend të rëndësishëm në jetën e tij intensive ushtarake zë edhe emërimi si drejtor i Përgatitjes Luftarake në

Ministrinë e Mbrojtjes nga viti 1966 deri në vitin 1972. Gjatë kësaj kohe ai drejtoi përgatitjet e stërvitjeve më të mëdha të ushtrisë, duke qenë edhe pjesëmarrës e kontribuues direkt në zhvillimin e tyre si dhe në hartimin e konkluzioneve të tyre.

Në krye të mendimit teorik dhe praktik të artit ushtarak shqiptar

I rëndësishëm është kontributi i gjeneralit Xhixho në shkencën ushtarake, në përpunimin e dokumenteve më të rëndësishme, në mendimin teorik dhe praktik të artit ushtarak shqiptar, përfshi edhe rregulloret e ushtrisë. Bërthama e përhershme e grupit përgjithësues studimor, i atashuar pranë MMP, përbëhej nga gjeneralët Ernest Jakova, Spiro Shalësi dhe Thoma Xhixho. Në vitin 1963 ky grup hartoi dokumentin kryesor të ushtrisë mbi Artin Ushtarak, i quajtur “Referati i Ministrit të Mbrojtjes”, si dhe “Materialin teorik ushtarak” në vitin 1967. Këto dokumente u bënë baza e referencës dhe udhëheqëse për çdo dokument të mëvonshëm, që lidhej me Artin Ushtarak.

Gjeneral Thomai është autor ose bashkautor në mjaft studime dhe përgjithësime shkencore. Si kryeredaktor i Revistës Ushtarako-Politike në ato vite, kontribuoi për ngritjen e nivelit shkencor të saj edhe me artikuj dhe punime konkrete të botuara në vite. Shkrimet e gjeneral Xhixhos datojnë që nga viti 1951 e deri në vitin 2000.

Në afro tetë dekada nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore janë larguar nga jeta komandantë, komisarë dhe luftëtarë të saj. Ata prehen përjetësisht në tokën shqiptare, që i kushtuan tërë jetën, duke mbetur të gjallë në kujtime, në foto, në relike, në stendat e muzeve dhe në faqe librash, duke frymëzuar përsëri njerëzit dhe duke ngjallur tek ata ndjenjat e fisnikërisë dhe të atdhedashurisë.

Është në nderin e gjithë shoqërisë sonë t’i nderojë këta idealistë e patriotë, që dhanë gjithçka për këtë popull e këtë vend në situata të vështira lufte, kur kishin përballë pushtuesit nazifashistë, kur vërshellenin mbi kokë plumbat e predhat e artilerisë dhe vunë në shërbim të atdheut gjithçka, kontributin e paharruar, deri dhe jetën e tyre sublime.

Thoma Xhixho dha shumë për ngritjen e Ushtrisë Kombëtare dhe më pas të Ushtrisë Popullore, për arsimin ushtarak, për shkencën dhe mendimin ushtarak shqiptar, për stërvitjet e mëdha ushtarake, si dhe për punën e madhe të bërë për publikimin e mjaft materialeve teoriko-shkencore në revistën politiko ushtarake.

28 NËNTORI, DITA E PAVARËSISË

NATO uron Shqipërinë: Bashkohuni me ne për të festuar me aleatin tonë

Aleanca e Atlantikut të Veriut, NATO ka uruar Shqipërinë për 110-vjetorin e ditës të Pavarësisë, më 28 nëntor 2022.

Me anë të një postimi në rrjetet e saj sociale, NATO ka zgjedhur një foto të ushtrisë shqiptare dhe flamurin tonë kombëtar për të uruar këtë ditë të shënuar, ndërsa i fton të gjithë që të bashkohen me urimin: "Bashkohuni me ne, për të festuar me aleatin tonë Shqipërinë, në Ditën e tyre të Pavarësisë!", - shkruan NATO.

Në vitin 2009, Shqipëria u anëtarësua në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut, NATO, pas përfundimit të ratifikimit të Protokollit të Anëtarësimit nga të gjitha vendet aleate dhe depozitimit të instrumentit të aderimit në NATO, në Departamentin e Shtetit, që është edhe mbajtësi ligjor i Traktatit të Uashingtonit.

Forcat e Armatosura Shqiptare tashmë kanë pësuar një transformim të rëndësishëm, duke u rreshtuar denjësisht në krah të ushtrive

të Aleancës, në misionet dhe operacionet e NATO-s. Që nga anëtarësimi zyrtar i Shqipërisë në NATO, ka nisur të zbatohet plani i integritetit, që nënkupton reformimin e thellë të sektorit të sigurisë e mbrojtjes, me qëllim ndërveprimin e plotë me NATO-n. Pjesë e këtij plani është paketa me 49 objektiva force, të cilat janë marrë përsipër nga FARSH-ja, si kapacitete operacionale të cilat vihen në dispozicion të NATO-s për misionet aktuale dhe të ardhshme.



Sekretari i Përgjithshëm pret Sekretarin Amerikan të Shtetit në takimin e Ministrave të Jashtëm të NATO-s

NATO është më e fortë dhe më e bashkuar se në çdo kohë

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg u takua me Sekretarin e Shtetit të SHBA-së Antony Blinken në Bukuresht, më 29 nëntor 2022 përpara një takimi të ministrave të Jashtëm të NATO-s.

Stoltenberg falënderoi Sekretarin Blinken për udhëheqjen e tij personale dhe mbështetjen e fortë ekonomike dhe ushtarake të SHBA-së për Ukrainën. "Ne duhet të qëndrojmë së bashku sepse është në interesin tonë të sigurisë të sigurojmë që presidenti Putin të mos fitojë, sepse kjo do të dërgojë mesazhin se liderët autoritarë mund të arrijnë rrugën e tyre duke përdorur forcën brutale ushtarake", - tha Sekretari i Përgjithshëm.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg:

Sekretari Blinken, i dashur Toni, mirë se vini në takimin ministror të jashtëm të NATO-s këtu në Bukuresht. Është gjithmonë kënaqësi të takohem me ju dhe ju falënderoj shumë për angazhimin tuaj personal, mbështetjen për NATO-n, për lidhjen tonë transatlantike. Ne po takohemi në Rumani dhe mendoj se është shumë në kohën e duhur dhe e rëndësishme, sepse Rumania është një fqinj me Ukrainën dhe ne shohim një luftë të ndezur atje. Një luftë ku Presidenti Putin po dështon, por ai po përgjigjet me më shumë brutalitet, duke sulmuar qytetet e Ukrainës, duke sulmuar infrastrukturën kritike dhe Putin tani po e kthen dimrin në një luftë ose një armë agresioni kundër popullit ukrainas. Prandaj, ne duhet të mbështesim Ukrainën, dhe unë jam jashtëzakonisht mirënjohës për mbështetjen e fortë nga Shtetet e Bashkuara: mbështetjen ushtarake, mbështetjen ekonomike dhe gjithçka që ju bëni për të ndihmuar ukrainasit.

Unë jam absolutisht i bindur se mesazhi nga takimi këtu, sot dhe nesër do të jetë se aleatët e NATO-s do të ofrojnë dhe vazhdojnë të ofrojnë mbështetje të paprecedentë për Ukrainën. Ne duhet të qëndrojmë së bashku sepse është në interesin tonë të sigurisë të sigurojmë që Presidenti Putin të mos fitojë, sepse kjo do të dërgojë mesazhin se liderët autoritarë mund të arrijnë rrugën e tyre duke përdorur forcën brutale ushtarake. Ne do të adresojmë gjithashtu sfidat që Kina paraqet për NATO-n, për interesat tona, për sigurinë tonë.



Dhe sigurisht që do të takohemi edhe me ministrin e Jashtëm Kuleba nga Ukraina, por edhe me ministrat e Jashtëm nga partnerët tanë

të ngushtë, Moldavia, Gjeorgjia dhe Bosnja - Hercegovina. Pra, edhe një herë, mirëseardhje. Është mirë të të shoh përsëri.

Sekretari i Shtetit të Shteteve të Bashkuara, Antony Blinken:

Faleminderit shumë. Faleminderit që na bashkëve këtij në Bukuresht.

Pajtohem me ju, ky takim nuk mund të ishte më në kohë dhe nuk mund të ishte në një vend më të mirë për arsyet që thatë. NATO është më e fortë dhe më e bashkuar se në çdo kohë që mbaj mend dhe e kam bërë këtë për gati 30 vjet. Kjo nuk është aspak e vogël, falë udhëheqjes së Sekretarit të Përgjithshëm Jens Stoltenberg, i cili ka qenë i jashtëzakonisht në sigurimin që Aleanca jonë të qëndrojë së bashku, e bashkuar në qëllim, e bashkuar në veprim. Ne do të riafirmojmë mbështetjen tonë për Ukrainën ndërsa shkojmë përpara. Ne do të riafirmojmë mbështetjen tonë dhe punën që bëjmë

për të forcuar Aleancën tonë. Puna që ishte jashtëzakonisht e rëndësishme në Samitin e Madridit dhe që tani do të mbartet në Vilnius vitin e ardhshëm. Së shpejti do të kemi dy anëtarë të rinj të Aleancës, Suedinë dhe Finlandën, me ne për këto takime sot. Kjo është gjithashtu e rëndësishme. Por parimi themelor që kemi dhe që ne mbartim në agresionin rus kundër Ukrainës, që ne i sjellim sfidave të tjera, duke përfshirë sfidat që Kina paraqet për interesat tona, është se ne po e bëjmë atë së bashku, ne po e bëjmë atë të bashkuar. Kjo është forca që Sekretari i Përgjithshëm ka ndihmuar për të ushqyer dhe është një forcë që ne do ta shohim të ekspozuar këtu gjatë dy ditëve të ardhshme. Faleminderit!

DEKLARATA: NATO DO TË MBROJË ÇDO CENTIMETËR TË TERRITORIT ALEAT NË ÇDO KOHË

Pushtimi i Ruisë në Ukrainë kërcënon paqen

Ministrat e Jashtëm të NATO-s trajtuan mënyrat për të rritur mbështetjen për Ukrainën në takimin e tyre në Bukuresht, Rumani, më 29 nëntor 2022. Pas takimit ministral e Jashtëm të NATO-s dolën me një deklaratë.

Deklarata e Ministrave të Jashtëm të NATO-s:
Të ftuarit e NATO-s lidhen me këtë Deklaratë.

1. Jemi mbledhur në Bukuresht, afër brigjeve të Detit të Zi, në një kohë kur pushtimi i vazhdueshëm i Ruisë në Ukrainë kërcënon paqen, sigurinë dhe prosperitetin euroatlantik. Rusia mban përgjegjësi të plotë për këtë luftë, një shkelje flagrante e së drejtës ndërkombëtare dhe parimeve të Kartës së OKB-së. Agresioni i Ruisë, përfshirë sulmet e saj të vazhdueshme dhe të pandërgjegjshme ndaj infrastrukturës civile dhe energjetike të Ukrainës, po privon miliona ukrainas nga shërbimet bazë njerëzore. Ajo ka ndikuar në furnizimet globale të ushqimit dhe ka rrezikuar vendet dhe popujt më të cenusur të botës. Veprimet e papranueshme të Ruisë, duke përfshirë aktivitetet hibride, shantazhin e energjisë dhe retorikën e pamatur bërthamore, minojnë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Ne qëndrojmë në solidaritet me Poloninë pas incidentit të 15 nëntorit që çoi në humbjen tragjike të jetëve si rezultat i sulmeve raketore të Ruisë kundër Ukrainës. Ne dënojmë mizorinë e Ruisë ndaj popullatës civile të Ukrainës dhe shkeljet dhe abuzimet e të drejtave të njeriut, të tilla si dëbimet me forcë, torturat dhe trajtimi barbar i grave, fëmijëve dhe personave në situata të cenusur. Të gjithë ata që janë përgjegjës për krimet e luftës, përfshirë dhunën seksuale të lidhur me konfliktin, duhet të mbajnë përgjegjësi. Ne gjithashtu dënojmë të gjithë ata, përfshirë Bjellorusinë, të cilët po lehtësojnë në mënyrë aktive luftën e agresionit të Ruisë kundër Ukrainës.

2. Ne mirëpresim sot Ministrin e Jashtëm Kuleba, qëndrojmë në solidaritet të plotë me qeverinë dhe popullin e Ukrainës në mbrojtjen e tyre heroike të kombit dhe tokës së tyre dhe bëjmë homazhe për të gjithë jetët e humbura. Ne mbetemi të palëkundur në angazhimin tonë për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës. Ne kurrë nuk do t'i njohim aneksimet e paligjshme të Ruisë, të cilat shkelin haptazi Kartën e OKB-së. Ne do të vazhdojmë dhe do të shtojmë më tej mbështetjen politike dhe praktike për Ukrainën ndërsa ajo vazhdon të mbrojë sovranitetin dhe integritetin e saj territorial dhe vlerat tona të përbashkëta kundër agresionit rus dhe do të mbajmë mbështetjen tonë për aq kohë sa të jetë e nevojshme. Në këtë kontekst, NATO do të vazhdojë të koordinohet ngushtë me palët përkatëse të interesit, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare, veçanërisht BE-në, si dhe vendet me të njëjtin mendim. Duke u bazuar në mbështetjen e ofruar deri më tani, ne do të ndihmojmë Ukrainën tani që të forcojë qëndrueshmërinë e saj, të mbrojë popullin e saj dhe të kundërshtojë fushatat e dezinformimit dhe gënjeshtër të Ruisë. Aleatët do të ndihmojnë Ukrainën

ndërsa ajo riparon infrastrukturën e saj energjetike dhe mbron njerëzit e saj nga sulmet me raketa. Ne gjithashtu mbetemi të vendosur në mbështetjen e përpjekjeve afatgjata të Ukrainës në rrugën e saj të rindërtimit dhe reformave të pasluftës, në mënyrë që Ukraina të mund të sigurojë të ardhmen e saj të lirë dhe demokratike, të modernizojë sektorin e saj të mbrojtjes, të forcojë ndërveprueshmërinë afatgjatë dhe të pengojë agresionin e ardhshëm. Ne do të vazhdojmë të forcojmë partneritetin tonë me Ukrainën ndërsa ajo avancoon aspiratat e saj euro-atlantike.

3. Finlanda dhe Suedia po marrin pjesë sot si shtete të ftuara për t'u anëtarësuar në Aleancë. Pranimi i tyre do t'i bëjë ata më të sigurt, NATO-n më të fortë dhe zonën euro-atlantike më të sigurt. Siguria e tyre është e një rëndësie të drejtpërdrejtë për Aleancën, duke përfshirë edhe procesin e anëtarësimit.

4. Duke kujtuar se Ballkani Perëndimor dhe rajonet e Detit të Zi janë të një rëndësie strategjike për Aleancën, ne mirëpresim takimin tonë me Ministrat e Jashtëm të partnerëve të NATO-s, Bosnjë-Hercegovinës, Gjeorgjisë dhe Republikës së Moldavisë, pasi NATO forcon mbështetjen e saj të përshtatur duke ndërtuar integritetin dhe qëndrueshmërinë e tyre, duke zhvilluar aftësitë dhe duke mbështetur pavarësinë e tyre politike. Ne qëndrojmë me vendosmëri pas angazhimit tonë ndaj politikës së detyrë të hapura të Aleancës. Ne riafirmojmë vendimet që morëm në Samitin e Bukureshtit të vitit 2008 dhe të gjitha vendimet pasuese në lidhje me Gjeorgjinë dhe Ukrainën.

5. NATO është një Aleancë mbrojtëse. NATO do të vazhdojë të mbrojë popullsinë tonë dhe të mbrojë çdo centimetër të territorit aleat në çdo kohë. Ne do ta bëjmë këtë në përputhje me qasjen tonë 360 gradë dhe kundër të gjitha kërcënimeve dhe sfidave. Ne dënojmë terrorizmin në të gjitha format dhe manifestimet e tij dhe qëndrojmë në solidaritet me Turqinë në pikëllimin e humbjes së jetëve pas sulmeve të tmerrshme terroriste të fundit. Ne përballemi me kërcënime dhe sfida nga aktorë autoritarë dhe konkurrentë strategjikë nga të gjitha drejtimet strategjike. Në dritën e kërcënimit më të madh për sigurinë euroatlantike në dekada dhe në përputhje me Konceptin Strategjik, ne po batojmë një bazë të re për qëndrimin tonë parandalues dhe mbrojtës, duke e forcuar ndjeshëm atë dhe duke zhvilluar më tej gamën e plotë të forcave të fuqishme dhe të gatshme dhe aftësive për luftim. Të gjithë këta hapa do të forcojnë ndjeshëm parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s përpara. Ne mbetemi të përkushtuar për t'u përgatitur, penguar dhe mbrojtur kundër sulmeve armiqësore në infrastrukturën kritike të Aleatëve. Çdo sulm kundër aleatëve do të përballim me një përgjigje të bashkuar dhe të vendosur. Ne qëndrojmë së bashku në unitet dhe solidaritet dhe riafirmojmë lidhjen e qëndrueshme transatlantike midis kombeve tona. Ne do të vazhdojmë të përpikemi për paqe, siguri dhe stabilitet në të gjithë zonën euroatlantike.

Koncepti Strategjik NATO-2022

Sfidë për Proceset tona Planifikuese të Sigurisë dhe Mbrojtjes



N/KOL. (R) MSC. KANAN HIMAJ
Në Institutin e Kërkimeve
Shkencës Ushtarake

Aleatët e NATO-s ranë dakord për Konceptin e ri Strategjik në Samitin e Madridit, qershor 2022. Ata ranë dakord ta bëjnë këtë dokument që në Samitin e Brukselit, qershor 2021, dhe krijuan një udhërrëfyes nga Brukseli në Madrid. Çfarë viti ka qenë – tashmë njihet ajo, si lufta për pushtimin rus të Ukrainës. Nuk ishte gjë e pazakontë që strategjia të bëhet në kohë krize dhe herë pas here studiuesit i identifikojnë kohët, veçanërisht te efektet e krizave. Megjithatë, nuk është e lehtë por e vështirë t'i shpëtosh rëndësisë së luftës konvencionale në shkallë të gjerë në Europë, përgjatë kufijve lindor të NATO-s.

Studiuesit, me seriozitet dhe përgjegjësi janë mbledhur disa herë në seksion të veçantë në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara, "West Point", për të dhënë draftin fillestar të Konceptit të ri Strategjik NATO - 2022. Nga studimet rezultoi se ata ishin një grup që përfshinte profesionistë të politikave nga NATO dhe vendet aleate, akademikë nga e gjithë bota, udhëheqës të lartë ushtarakë nga të dy anët e Atlantikut dhe pedagogë e kadetë të akademisë "West Point". Ata kanë prezantuar, si kërkime akademike të fundit, ashtu edhe analiza të politikave që pasojnë, sintetizojnë, kritikojnë dhe zhvillojnë më tej atë kërkim dhe analizë.

Nisur nga përmbajtja, Koncepti është vizion politik-strategjik, i cili bazohet në fuqinë efektive ushtarake. Prandaj, fokusi i tij kryesor është në identifikimin e parimeve, parametrave dhe udhëzimeve të nevojshme për zhvillimin e politikave të duhura, planifikimin strategjik-operacional, strukturën e forcës dhe aftësitë e saj. Kjo përfshin përmirësimin e ndarjes së barrës transatlantike dhe krijimin e një aleance më të ekuilibruar, të mundësuar për të marrë më shumë përgjegjësi për mbrojtjen kolektive, të jenë reagues e të besueshëm në raste të krizave dhe emergjencave.

Koncepti Strategjik 2022 bazohet në Axhendën e NATO-s 2030, që ajo të jetë më efektive nëpërmjet kohezionit më të madh politik; gatishmërisë, aftësisë dhe kapacitetit të përmirësuar të FA-ve aleate; qëndrueshmëria e rritur; ndarje më e drejtë e barrës; një marrëdhënie të përforcuar NATO-BE dhe me vendet partnere. Gatishmëria më e mirë e NATO-s për të përballuar kërcënimet që vijnë nga teknologjitë në zhvillim është gjithashtu thelbësore për Konceptin Strategjik 2022.

Thelbi dhe sfidat e NATO-s qëndrueshmëria e aleancës: Ruajtja e paqes, mbrojtja e njerëzve, i miratuar në samitin e NATO-s, të qershorit 2022, në Madrid, vendos tre synime kryesore për Aleancën: të



jetë mjaftueshëm e fortë ushtarakisht, të jetë më e bashkuar politikisht dhe të adoptojë një qasje më të gjerë globale ndaj sigurisë dhe mbrojtjes.

Misioni i Konceptit Strategjik është të mbrojë territoret, popullsinë, vlerat dhe forcat e Aleancës. Ai ka pesë elementë thelbësorë: (1) mbrojtjen e vlerave tona, (2) forcimin e fuqisë ushtarake të NATO-s, (3) forcimin e shoqërive të Aleancës, (4) miratimin e një pikëpamjeje globale dhe (5) ruajtjen e Aleancës si lidhje institucionale jetike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut.

Puna shkencore ka treguar në thelb çështjet kryesore që duhet të merrnin parasysh prioritetet strategjike të NATO-s për dekadën e ardhshme. Në këtë kontekst, në Dokumentin e Konceptit gjejmë përgjigjet e pyetjeve: se çfarë është Koncepti Strategjik i NATO-s dhe, pse NATO e zhvilloi atë në vitin 2022? Sigurisht që dokumenti është i hapur dhe në dorën e shumëkujt, i cili çdo ditë nga ne studiohet, vlerësohet dhe na jep horizonte të gjera për perspektivën e sigurisë së vendit dhe jo vetëm.

Ndasitë, përçarjet dhe shkatërrimi po shihen si rreziku, sfida dhe kërcënimi me të cilin Aleanca duhet të përballë përmes një mbrojtjeje, parandalimi dhe angazhimi. NATO do të ruajë ose rivendosë integritetin dhe sigurinë e zonës Euro-Atlantike në të

gjitha rrethanat, duke përdorur forca dhe burime të tilla që mund të jenë të nevojshme, si pjesë që kombinon reagimin fleksibël dhe praninë. Ajo do t'i përshtatet më tej karakterit dhe sjelljes së luftës që ndryshon me shpejtësi, e cila tani shtrihet në një mozaik të luftës së informacionit, luftës kibernetike, luftës "konvencionale" gjithnjë e më e shpejtë (e njohur edhe si hiperluftë, tej/mbi/energji, etj.) dhe luftës bërthamore. Megjithatë, edhe me një rritje të dukshme të aftësive dhe kapaciteteve ushtarake, forcat dhe burimet do të jenë gjithmonë të kufizuara në shtrirje, duke pasur parasysh shkallën e sfidave të nënkuptuara në spektrin e plotë të misionit të NATO-s. Duhet të arrihet një ekuilibër midis ruajtjes së parandalimit dhe mbrojtjes së besueshme në krahun verior dhe lindor të Aleancës; angazhim efektiv të sigurisë rreth Mesdheut, Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore; sigurisë së Atlantikut të Veriut dhe të sigurisë së globale, të cilat janë jetike për funksionimin strategjik të saj.

Aleanca do të vazhdojë të kërkojë dialogun me Rusinë dhe të respektojë Aktin Themelues NATO-Rusi, edhe pse Rusia vazhdon të shkelë vlerat, parimet, besimin dhe angazhimet e përkrahura në dokumente të tjera të dakorduara, që mbështesin marrëdhëniet NATO-Rusi. Veprimet agresive të Rusisë dhe sjellja gjithnjë e më sfiduese e Bjellorusisë – e përforcuar nga aftësia

ushtarake në rritje e Moskës – vazhdojnë të përbëjnë kërcënimin për sigurinë dhe mbrojtjen e aleatëve. Pushtimi i paligjshëm i Krimesë, destabilizimi dhe agresioni ndaj Ukrainës, mbështetja për separatistët dhe mohimi i aspiratës legjitime të Ukrainës për të zgjedhur aleancat e saj, janë pjesë e një politike më të gjerë të detyrimit kompleks strategjik me të cilin Aleanca duhet të përballë. Prania ushtarake në rritje e Rusisë në Bjellorusi dhe nxitja e mijëra emigrantëve të dëshpëruar drejt Polonisë tregojnë për një politikë të sjelljes rreth kufijve të Rusisë, të drejtuara nga Kremli, e krijuar për të minuar sigurinë dhe stabilitetin e aleatëve në rajon.

Modeli agresiv i Rusisë përforcohet nga aftësitë në rritje të projektimit të fuqisë së forcave të armatosura, të cilat janë krijuar për të kërcënuar krahun lindor të NATO-s dhe rajonin e Detit të Zi. Lufta në Ukrainë, stërvitjet e kombinuara me presionin e vazhdueshëm ushtarak në kufijtë lindorë dhe veriorë të Ukrainës, sugjerojnë se Moska tashmë është e përfshirë në një konflikt me synimin për të shtrirë në pjesën më të madhe të Evropës Lindore. Ajo është e angazhuar në kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e municioneve të avancuara, të cilat synojnë

të krijojnë një avantazh të qartë ndaj NATO-s, në zonat që Moska i konsideron jetike për interesat e saj, dhe në një kohë që forcat ruse mund të sjellin fuqi të mëdha. Deti Arktik, Svalbard, Kepi i Veriut dhe Finmark, shtetet baltike, Bjellorusia, Ukraina dhe rajoni i Detit të Zi janë të gjitha zona ku Rusia është aktive. Për NATO-n kjo është sfidë dhe duhet t'i përgjigjet kësaj sfide.

Terrorizmi sfidon rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke kërkuar të minojë demokracinë dhe stabilitetin në mbarë globin. Rrjedhimisht, terrorizmi duhet parë gjithashtu si një kërcënim parësor për Aleancën.

Koncepti Strategjik i NATO-s, i miratuar nga shtetet dhe qeveritë aleate, është marrëveshja e nivelit më të lartë, që përcakton drejtimin strategjik të Aleancës. Duke qenë se NATO është një organizatë e drejtuar nga konsensusi, çdo aleat është potencialisht një "lojtar i vetos". Koncepti Strategjik përshkruan qëllimin e NATO-s dhe detyrat e saj thelbësore. Dokumenti gjithashtu artikulon kuptimet e përbashkëta të aleatëve për mjedisin e sigurisë në të cilin ata veprojnë: sfidat, mundësitë dhe kërcënimet.

Veçojmë se, në kushtet e formimit të Konceptit Strategjik të NATO-s, pushtimi i Ukrainës nga Rusia duket se ka rritur konsensusin për këtë të fundit dhe aleanca forcohet mbi atë konsensus për të ndërmarrë hapa në Konceptin e ri Strategjik.

Koncepti Strategjik i NATO-s është afërsisht analog me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të SHBA-së – 2022 pasi ajo ofron udhëzime strategjike dhe politike të nivelit shumë të lartë, të cilave mund t'u drejtohen politikisht dhe planifikuesit ushtarakë të aleancës kur formulojnë politika në fusha kyçe, duke filluar nga përshtatja dhe zhvillimi i aftësive deri te trajnimet dhe stërvitjet me fokus të mësimave të nxjerra nga kërcënimet e sotme.

Përveç planifikimit të dy viteve të fundit, Koncepti Strategjik NATO-2022 pasqyron gjithashtu punën planifikuese të politikave dhe ushtarake, të cilat kërkojnë të ofrojnë përditësime strategjike të luftës në Ukrainë nga Rusia, vijon të zbatojë përshtatjet nga Deklarata e Samitit të Uellsit dhe që çojnë në një sërë dokumentesh, që me siguri pasqyrohen në konceptin strategjik.

Së fundi, Konceptet Strategjike pasqyrojnë gjithashtu strategjitë kombëtare të aleatëve që bien dakord me to, duke bërë të mundur reflektimin e procesit të Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes së vendit, me qasje më të drejtuar për dokumentet si Udhëzimet e Politikës për Sigurinë, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare apo Strategjinë Ushtarake, të cilat janë në momentin më të mirë për rishikimin e tyre.

40 HANET E SHQIPERISË

Hanet janë struktura të vogla me arkitekturë tradicionale, të cilat kanë qenë të përhapura në të gjithë territorin e Shqipërisë. Këto struktura kanë ekzistuar që nga periudhat e vjetra dhe kanë vazhduar madje deri në gjysmën e parë të shekullit të XX. Ato kryenin funksionet e akomodimit, fjetjes dhe ushqimit për udhëtarët e ndryshëm vendas apo të huaj. Po kështu edhe funksionet e strehimit dhe të ushqimit të kuajve për udhëtarët dhe karvanët e ndryshëm që lëviznin në atë periudhë kohe. Shumë nga udhëtarët e ndryshëm të cilët kanë vizituar Shqipërinë, duke përmendur këtu udhëtarin dhe poetin anglez Lord Bajronin, udhëtarin dhe studiuesen angleze Edit Durham, konsullin francez Pukëvil, profesorin e Universitetit të Vjenës, Karl Patch, historianin anglez Hamond, e shumë e shumë të tjerë, i kanë përshkruar në shkrimet e tyre këto lloj strukturash, duke venë në dukje anën e tyre autentike dhe mikpritjen e gjetur në to. Sot, duke jetuar kohët moderne dhe në një periudhë globalizimi, turistët janë të prirur në kërkim të origjinale dhe të asaj e cila mbetet e veçantë. Në këtë kontekst, duhet të përmendim edhe projektin e "40 Haneve" të ndërmarrë nga ana e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ky projekt synon rivitalizimin e këtyre strukturave të vjetra dhe "epike" të Shqipërisë, në mënyrë që ato të përshatën si struktura akomoduese për turistët. Objekti kryesor i këtij projekti është zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar bukuritë natyrore dhe kulturën e këtyre zonave. Po kështu, diversifikimi i ofertës turistike, nëpërmjet formave të ndryshme të turizmit, siç janë agro-turizmi, eko-turizmi, turizmi kulturor, ai malor, etj. Padyshim që është i përfshirë në këto aktivitete dhe komuniteti vendas. Zona ku përfshihet ky projekt është shumë i gjerë, por specifikisht është ai i veriut të Shqipërisë, në zonat e malësisë së Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe. Gjithsesi, mundësitë janë që ky lloj turizmi të shtrihet në të gjithë territorin e vendit.

Turizmi i Haneve në Shqipëri Hani i GJON DUKGILAJT Hani në VERMOSH

Përbën skajin më verior të Republikës së Shqipërisë. Ai gjendet në një distancë prej 95 km nga qyteti i Shkodrës. E gjithë kjo zonë quhet krahina e Kelmendit. Këtë emër mban edhe komuna në fjalë. Ky emërtim vjen nga fjala latine "climens", që do të thotë i urtë, i thjeshtë, i mirë. Mbasi udhëtohet në një rrugë dramatike dhe spektakolare malore nga Shkodra për në Vermosh, duke kaluar objekte të tilla si qafën e Rrapshit dhe urën e Tamarës mbi lumin e Cemtit, udhëtarit mbërrin në fshat, i cili është ngritur mbi një fushë malore të krijuar nga lumi i Vermoshit, apo siç quhet ndryshe lumi i Limit. Gjendemi në një luginë me origjinë akullnajore, të vendosur në lartësinë 1.100 metra mbi nivelin e detit. Në të dy anët e luginës, ngrihen shpate malesh me pjerrësi të konsiderueshme dhe të veshura me pyje dhe kullota. Bimësia drunore përbëhet kryesisht nga ahu dhe halorët. Vermoshi shquhet për panoramën e tij si dhe për reshjet e dëborës që zgjasin afro 100 ditë në vit. Një ndër aktivitete, të cilat zhvillohen për çdo vit në Vermosh është "Logu i Bjeshkëve", ku kryhet konkurrencioni në të cilin zgjidhet "Miss Bjeshka". Vajzat konkurruese ekspozojnë kostume kombëtare tradicionale të zonës së Kelmendit dhe Malësisë së Madhe. Në këtë aktivitet marrin pjesë shumë kelmendas



të emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada dhe Angli. Deri në vitin 1992, fshati kishte 1 300 banorë, ndërsa aktualisht 530 prej tyre kanë emigruar sidomos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku janë vendosur kryesisht në Detroit. Aktivitetet kryesore të cilat mund të zhvillohen në Vermosh janë ngjijtjet malore në malësinë e Marlulës, shëtitjet në luginat e thella alpine, (të Lëpushës dhe Cemtit), skitë në shpatet natyrore me dëborë, peshkimi sportiv i troftës, etj. Një aktivitet tjetër janë turet e biçikletave malore. Hartat e rrugëve të tyre janë përgatitur nga ana e studentëve të universitetit të Shkodrës dhe Podgoricës me mbështetjen e projektit Gjerman, GTZ. Këtë tur e përfshijnë të dy vendet, Shqipëria dhe Mali i Zi. Zona e Vermoshit është e përmendur për cilësinë e lartë të bulmetrave. Shquhen më së shumti kullotat në stanet e Seferçës, i cili është edhe skaji më ekstrem verior i Republikës së Shqipërisë. Vermoshi është i njohur edhe për kultivimin e patateve.

Hani i Gjergj Franit Hani i Nik Donit Hani i Nikollë Nacajt Hani i Lucë Shquajt Hani i Gjok Bujajt Hani i Ndoc Bujajt Hani i Zef Tinajt Hani i Nikoll Volajt Hani i Prelë Vuktilajt Hani i Marash Vushajt Hani i Nikolin Rexhajt Hani i Prele Tinajt Hani i Lekë Vukajt Hani i Llesh Nikollës Hani i Marash Plumbit Hani në Theth

Rajoni i Thethit përbën zemrën e alpeve shqiptare. Ai ndodhet në alpet perëndimore të Shqipërisë, në një distancë prej 70 km larg nga qyteti i Shkodrës. Për vlerat e tij klimaterike dhe atë të biodiversitetit, Thethi është shpallur

një Park Kombëtar, i cili është gjithashtu edhe pjesë e projektit të përbashkët të "Parkut të Paqes", që përfshin një rajon ndërkufitar të "Bjeshkëve të Namuna" midis tre shteteve, Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi. Sipërfaqja e parkut kombëtar përfshin një areal prej 2 630 hektarësh dhe shtrihet në një lartësi prej 600 deri 2 570 metra mbi nivelin e detit. Këtu ka një mbulesë të dendur drunore ku 90 për qind e saj përfaqësohet nga pyjet e dendura të ahut. Në parkun e Thethit, gjenden ahe shekullore me diametër të trungut nga 1 deri në 1,5 metra. Lloji tjetër i mbulesës drunore përbëhet nga panja, frashri, shkoza dhe rrobulli. Ka një shumëllojshmëri lulesh, ku vlen për t'u përmendur "Wulfenia e Baldachit", e cila është bimë endemike e zbuluar nga botanisti italian Baldachi. Kjo lloj luleje gjendet vetëm në parkun e Thethit.

Fauna e parkut përbëhet nga 50 lloje shpendësh, 10 lloje reptilësh dhe 8 lloje amfibësh. Vlen të përmendim se Parku i Thethit mbetet habitati më i rëndësishëm në vendin tonë me popullimin e rrëqebullit, specie kjo mjaft e rrezikuar. Këtu gjenden edhe lloje të ndryshme qukapikësh, shqiponja e artë, salamandra alpine si dhe një shumëllojshmëri fluturash shumëngjyrëshe. Në ujërat e përroit të Thethit, gjendet edhe trofta e mermertë. Ndër objektet më interesante për t'u vizituar nga ana e turistëve në Theth janë ujëvara e Grunasit e cila ka një lartësi prej 25-30 metrash. Pranë saj gjendet shpella e "Birrëve me rrathë", në galeritë e së cilës gjenden forma të ndryshme si stalaktite, stalagmite, vello muresh, etj. Shpellë tjetër është ajo e Arapit. Mjaft tërheqëse janë burimet e ujërave të Okolit, nga ku burojnë ujërat e përroit të Thethit. Parku kombëtar i Thethit shquhet për reshjet e dendura të dëborës, të cilat zgjasin normalisht

150 ditë në vit. Mund të themi se për afro 6 muaj kjo zonë mbetet e bllokuar nga dëborë e cila zë Qafën e Tërthores 2 000 metra mbi nivelin e detit, e cila lidh Bogën me Gropën e Thethit. Në Theth bien në sy ndërtesat e tipit alpin me çati të pjerrët të ndërtuara me ploça guri. Këtu gjendet edhe "Kulla e ngujimit", element ky epik i jetesës shqiptare ku gjatë periudhës së gjakmarrjes strehohej gjakësi. Kjo kullë është sot monument kulturore. Kuzhina tradicionale e Thethit përbëhet nga "fërliku", (mish i pjekur), gatimi i troftës së përroit të Thethit, si dhe nënproduktet e qumështit, (djathërat e ndryshëm, gjiza, kosi i freskët, etj.). Në Theth mund të organizohen aktivitete të shumta në natyrë, si ngjijtjet malore, speleologjia, (turizmi i shpellave), kajakët në përroit e Thethit, peshkimi sportiv malor, sportet dimërore në shpatet natyrore me dëborë, biçikleta malore, etj.

Hani i Mëhill Carkut Hani i Gjon Frashnishes Hani i Fran Mollës Hani i Gjon Ded Dojës Hani i Pal Rupajt Hani i Gjovalin Lokthit Hani i Nikoll Polisë Hani i Lulash Kometës Hani në Margegaj

Është fshati dhe qendra e komunës me të njëjtin emër, i cili ndodhet vetëm pak kilometra në veri të qytetit të Bajram Currit. Kjo zonë ndodhet në alpet lindore të Shqipërisë, ku atraksioni kryesor turistik është Parku Kombëtar i luginës së Valbonës. Ky është njëri prej parqeve më të mëdhenj të Shqipërisë me një sipërfaqe prej 8 000 hektarë. Pranë hyrjes për në luginën e Valbonës do të keni mundësi të shikoni burimin (vrellën) e Shoshanit, i cili është një

burim karstik. Ky i fundit derdhet në lumin e Valbonës duke krijuar një kanion tërheqës me gjerësi 2-3 metra dhe thellësi 50 metra. Krahas të tjerash vlen për t'u përmendur se në komunën e Margegajt gjenden disa shpella interesante siç është ajo e Haxhisë, (120 metra e gjatë) dhe shpella e Akullit, (e cila ka një gjatësi të eksploruar prej 250 metrash).

Hani i Alfred Selimajt Hani i Kol Gjon Jubanit Hani i Sherif Selimajt Hani i Lazër Cardakut Hani i Mark Lamthit Hani i Ilirjanit Lamthit Hani në Fushë-Arrëz

Fushë-Arrëzi është një qyteti i ri, i cili gjendet në rrugën nacionale nga Puka drejt Kukësit dhe Kosovës. Ai është ndërtuar si rezultat i ndërtimit të fabrikës së pasurimit të bakrit si dhe për shfrytëzimin e lëndës drusore, me të cilin ky rajon është i pasur. Në qytet gjendet kisha katolike e "Shën Jozefit" ndërsa ndër aktivitetet të cilat zhvillohen këtu mund të përmendim "Festivalin mbarëkombëtar të instrumentistëve të vegjël", i cili zhvillohet gjatë muajit maj. Fushë-Arrëzi ofron mundësi të tjera për aktivitete. Kështu në malin e Krrabit, i cili ndodhet pranë qytetit, gjenden livadhe të këndshme dhe shumë kroje natyrore me ujë të ftohtë. Ky është një vend mjaft i përshtatshëm për organizimin e piknikëve dhe turizmit me çadra. 3 km larg nga Fushë-Arrëzi, gjenden rrënojat e kalasë së Micojit, e cila i përket shekullit të XVI. Gatimet tradicionale të zonës janë çervishi me lëng pule, fërliku, flija, laknori, (i gatuar me arra, hithra dhe qepe), etj.

Hani i Hamit Mustafës Hani i Zek Currit Hani i Zef Ndocit Hani në Pukë

Qyteti ndodhet në veri të Shqipërisë, në një lartësi prej 838 metrash mbi nivelin e detit, duke përbërë në këtë mënyrë një prej qyteteve më të larta të vendit tonë. Ajo ndodhet në një distancë prej 150 km larg nga kryeqyteti, Tirana. Puka njihet për zejen e përpunimit të rrëshirës, ku ka një traditë 2 000-vjeçare. E pozicionuar në rrugën nga deti Adriatik drejt Kosovës, në shek. II-IV, në këtë zonë u zhvillua qyteti antik me emrin Picarea dhe më pas Pezhve. Gërmadhat e kësaj të fundit janë zbuluar në një lagje të qytetit të Pukës, e cila mban këtë emër. Qyteti shquhet për ajrin e pastër, duke qenë se rrethohet edhe nga një pyll pishash prej 400 hektarësh. Pranë qytetit ka edhe një pistë natyrore, ku mund të ushtrohen rrëshqitjet me ski. Ajo shërben si një bazë e mirë për ushtrimin e alpinizmit në malin e Munellës dhe në bjeshkët e Tërbunit. Objekte të tjera janë burimi i ujërave i quajtur "Mrizi i zanave", "Shkëmbi i zanave", "Shpella e Kaurit", e cila ndodhet në fshatin Levrushk. Kjo shpellë ka një gjatësi prej 250 metrash të eksploruara dhe për të shkuar aty ndiqet itinerari Puke-Qelëz-Levrushk. Një objekt tjetër i trashëgimisë kulturore është "kulla me karakoll", e gjendur në fshatin Kokodë, e cila është e vetmja e këtij lloji që ka mbetur ende në Shqipëri. Gjatë viteve 1936-1937, në qytetin e Pukës ka punuar poeti i shquar i letrave shqipe, Migjeni. Sot turistët mund të vizitojnë muzeun e tij në shkollën ku ai ka dhënë mësim. Gatimet tradicionale të zonës janë "fërliku", "mazja", (gatim i veriut të Shqipërisë me miell misri), etj. Në qytetin e Pukës prodhohet edhe një birra e llojit "bio".

SHKOLLA USHTARAKE "SKËNDERBEJ"

Skënderbegasi Pirro Mani, regjisori i famshëm shqiptar

Pirro Mani lindi, më 14 prill të vitit 1932, në Korçë, është aktor dhe regjisor i njohur shqiptar. Është një nga personalitetet më të shquar në historinë e teatrit shqiptar. Regjisor dhe pedagog i shkëlqyer, për 25 vjet punoi në Teatrin Kombëtar. Është një ndër nxënësit e shkollës Ushtarake "Skënderbej", që u bë i famshëm në fushën e artit. Studioi në Institutin Shtetëror të Artit Teatror, GITIS, në Moskë. Pas kthimit në atdhe u emërua regjisor i Teatrit "A. Z. Çajupi", Korçë, të cilin e drejtoi me sukses për rreth tetë vjet. Që nga 1967 -1992 ka qenë regjisor i Teatrit Kombëtar, ku ka vënë me dhjetëra pjesë teatrale. Në karrierën e tij artistike numëron mbi 80 shfaqje. Është nderuar me shumë çmime. Është mjeshër i regjisë e skenave masive, njohës i thellë i mizanskenës. Shfaqjet kulminante janë "Cuca e maleve", "Fytyra e dytë", "Arturo Ui", "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", "Epoka para gjyqit", "Nata e 12 -të", "Prometeu", etj. Është angazhuar edhe në disa filma artistikë. Ka fituar shumë çmime dhe është nderuar me titullin e lartë "Artist i popullit". Prej disa vjetësh jetoi në Nju Jork, SHBA, së bashku me të shoqen, aktoren e mirënjohur Pavlina Mani dhe familjen. Mbetet brilant në disa role (aktor) si në "Loin des barbares", 1994, Luan Kodra, "I teti në bronz" (1970), "Sali Protopapa", "Vitet e para" (1965),



"Stavri Lara", etj...

...Historia e rrugës së artit për Pirro Manin, ka qenë histori suksesi, por edhe peripecish e vuajtjesh të shumta.... Pirro Manin e kish puthur fati në ballë, se në laboratorët e teatrit korçar pati

nën urdhrat e tij regjisoriale, aktorë të klasit të parë, si Pandi Raidhi, bashkëshortët Dhorka dhe Dhimitër Orgocka, Thimi Filipin, Stavri Shkuritin e të tjerë, që Mani s'i hiqte nga goja. Së bashku, ata realizuan vepra

me vlera të qëndrueshme e që lanë mbresa në kujtesën e artdashësit, si; "Hijet e Natës" të V. Kokonës, apo që dëshmuar art të shquar regjisorial dhe aktorial, edhe pse të ngopura me politizime, si "Kënetë" e Fatmir Gjatës, që fituan pëlqimin e autoriteteve. Haraçe si kjo e fundit, bënë të mundur që në skenën e Korçës t'u hapet dera mysafirëve të përjetshëm: Shekspirit, Moliërit, Bernard Shout, Ostrovskit... Sukseset e ndritshme të farkëtuara në kudhrën e Korçës, e sollën Pirro Manin në teatrin qendror të vendit dhe i hapën atij horizonte më të gjëra e mundësi më të mëdha, por historia që thamë, tamam në ato vite, solli krizat më të mprehta e dramet më të mëdha shoqërore, që si për të përqeshur artin e skenës, nuk do të ngjiteshin dot kurrë mbi një skenë teatri... Ai kërkoi e gjeti vepra që e bënë atë regjisorin më të mirë të teatrit shqiptar. Ai realizoi "Cucën e Maleve", "Fytyrën e Dytë", "I pazëvendësueshmi", "Epoka para Gjyqit", "Shënomeni dhe Mua", "Gjeneralin e Ushtrisë së Vdekur", që ofronin hapësira të bollshme të frymëzimit regjisorin dhe interpretët, të kënaqin dhe spektatorët e lozhës dhe ata të platesë.

Ja çfarë shprehte kohë më parë i madhi Pirro Mani:

"Diktatura, e di që një pjesë teatrale me ide të papëlqyeshme për të, është mijëra herë më e rrezikshme se

një vepër letrare heretike... Shumë vetë e kanë kollaj t'i venë kryqin teatrit tonë të asaj kohe. Duhet të matesh mirë që të analizosh drejt kulmet e pakta, por të matesh edhe për shtrembërimin e tij, degradimin dhe përdhunimin e tij... Një nga shfaqjet më të bukura të mia, unë mbaj "Rrethimin e Bardhë" të Naum Priftit, që e rrezoi vetë Enver Hoxha, në një nga vizitat e tij në Korçë. Fabula ishte mbi rezistencën njerëzore në kushtet e rrethimit nga dëborat dhe mendohej se do të kalonte me pasaportën e temës së rrethimit kapitalisto-revizionist. Unë u dashurova pas veprës. Sapo kisha ardhur nga Moskë, ku destalinizimi po shkrinte çdo lloj akulli. Në tërë katet e Universitetit "Lomonosov" kërciste rock&roll-i nga gëzimi i hapjes së horizonteve. Kurse këtu... Unë arrita që tërë këtë përjetim ta plazmoja në atë dramë. I madhi e kapi menjëherë nostalgjinë time dhe e fundosi atë spektakël aq të ndjerë... Sinqerisht, ka qenë një nga punët më të bukura që kam bërë... Kam pasur fatin e madh të punoj me skenografë të jashtëzakonshëm si Agim Zajmi, Shaban Hysa, Ksenofon Diloja. Bashkëjetesa me ta më ndihmoi mjaft që të përvetësoja më mirë ligjet e arkitekturës skenike dhe më mprehu kërkesat".

Minush Jero, jetë e mundimshme e një artisti të famshëm

Minush Jero (Emin Masar Jero), u lind më 27 qershor 1932, në lagjen "Skelë" të Vlorës dhe vdiq më 22 mars 2006, Durrës, kohë në të cilën kryente detyrën e Drejtorit të teatrit "Aleksandër Moisiu" të këtij qyteti. Pas përfundimit të shkollës "Skënderbej", ai u diplomua në fushën e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin e Tiranës. Ndërsa ishte ende student shkroi tregime të shkurtra, por pati sukses dhe në lëvrimin e dramës e interpretimet si aktor me pjesët "Dashuria në kohën e luftës", "Ura", "Historia e një nate", etj... Fillimisht, shumica e veprave të tij kishin si tematikë atë të Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1969 ai shkroi dramën "Njollat e murrme", për të cilën nis kalvari i vuajtjeve...

Pas Festivalit XI të Këngës në RTVSH (dhjetor 1972), filloi një spastrim në qarqet artistike. Minush Jero u arrestua më 30 prill, 1973. Gjyqi filloi në dhjetor të vitit 1973. Më 9 shkurt 1974, Gjykata Rajonale në Tiranë e gjeti atë fajtor për krimin e agjitacionit e propagandë e drejtuar kundër qeverisë së popullit dhe dënohet me 8 vite burg. Me kalimin e kohës, ky dënim ndryshoi në 6 vjet e 8 muaj. Jero la burgun në Ballsh, më 28 dhjetor 1978. Në vitet 1979-1987 ai ka punuar si punëtor krahu në një fabrikë në Durrës. Në vitin 1990, ai ishte ndër të parët që nxitu e përkrahu proceset demokratike... Në vitin 1998,



ai ra viktimë e një aksidenti me makinë. Nga ky dëmtim ai ra në shtrat e pati pasojë, deri në ndarjen nga jeta...

.. "Një hap para vdekjes" ishte vepra e fundit e Minushit, ku përshkruante kalvarin e gjatë të jetës së tij, por edhe

shumë poezi dhimbjeje që ai donte t'i përmbledhte në një vëllim. "Minush Jero ishte dramaturgu i guximshëm dhe i talentuar, që vuajti të gjithë jetën dhe nuk i botoi veprat e tij". Kështu do ta përkufizonte Minush Jeron, artistin, një nga miqtë e tij më të mirë, regjisorin i njohur durrsak Gjergj Vlasi. Duke e vlerësuar si një nga dramaturgët më të mirë, Gjergj Vlasi e shikon jetën e Mirush Jeros si një dramë të vërtetë në të cilën ai ishte personazhi më tragjik. "Ndonëse ishte ndër dramaturgët më të mirë të letërsisë shqipe, askush nuk u kujtua për së gjalli të nderonte figurën e tij, ndonëse në librin "Historia e teatrit botëror" emri i tij është ndër të rrallët e letërsisë shqipe. Ai shkroi shumë drama, por jeta e tij ishte një dramë e vërtetë dhe në të ai ishte personazhi më i dhimbshëm. Përjetoi burgun në kulmin e karrierës, sëmundja e burgosi 8 vjet në shtëpi dhe nuk mori asnjë titull ndonëse e meritonte si askush", -pohon Vlasi. Një nga kryeveprat e Jeros është libri "Njolla të murrme", pas të cilit do të fillonte dhe persekutimi dhe burgosja e artistit. E frymëzuar nga erërat e demokracisë së shkurtër të vitit 1968, kjo dramë u ndalua menjëherë, që në premierë nga vetë diktatori Enver Hoxha, si një vepër liberale. Sipas Vlashit, vepra e Minush Jeros dallohet për trajtimin e konfliktualitetit

në mënyrën më të gjallë dhe të vërtetë. "Ai nuk shkroi shumë, por vepra që la është cilësore", - shprehet Vlasi, duke shtuar se Jero është ndër rastet unikalë që, sa që gjallë, nuk iu botua vepra e tij. Ndërkohë që drama "Njolla të murrme", për të cilën dhe u dënua, është vënë në skenë dhe nga një trupë franceze në Paris. Në ditën e vdekjes së Minush Jeros, më 22 mars 2006, mungonin përfaqësuesit e pushtetit lokal apo të Ministrisë së Kulturës, të cilët e kaluan në heshtje vdekjen e tij. Megjithatë, sipas Vlashit, këto institucione do ta nderonin në të vërtetë këtë figurë, nëse do të botonin veprën e plotë të tij... Familjarët të tregojnë një album të vjetër, ku përmbledhet e gjithë jeta e Minush Jeros, që nga koha kur ishte skënderbegas, kohën e luftës kur ishte debatikas, kur ishte ndër 3 të rinjtë shqiptarë që përfaqësuan Shqipërinë në Kongresin e parë të Rinisë Antifashiste shqiptare. Më tej vijnë fotot e kohës, kur së bashku me regjisorin Gjergj Vlasi vuri në skenë dramën "Njolla të murrme", pas së cilës e arrestuan dhe më pas e dënuan me 8 vjet burg. Ishte viti 1973 dhe regjimi Hoxha sapo kishte nisur të godiste elitën e intelektualëve e artistëve shqiptarë, si Fadil Paçrami, Todi Lubonja e shumë të tjerë. Pas kësaj periudhe të errët, kur Jeros nuk iu lejua të shkruajë asnjë rresht nga dramat që

kishte pasion, vijnë fotot nga koha kur punonte si punëtor në Fabrikën e gomës në Durrës. Gjatë gjithë kësaj kohe ai pati pranë gruan e tij, e cila iu gjend pranë në momentet më të vështira. Në albumin me foto të Minush Jeros shfaqen dhe foto të dramave të shfaqura në Korçë, Durrës, Paris etj. Në bibliotekën e tij personale, gruaja e Minushit dhe djali të tregojnë kopjen e rrallë të librit "Njolla të murrme", i cili ndikoi shumë, jo vetëm në jetën e Minushit, por edhe në jetët e tyre. Por aty ka edhe drama të tjera të tij, si "Një hap para vdekjes", "Dramë mbi mitologjinë", "Unë jam dashuria juaj" e shkruar gjatë viteve që punonte në fabrikë, por edhe dorëshkrimet e dramave që e shkelën skenën e teatrit, si "Jashtë bie shi", "Hapni dritaret", "Shokët", "Dasmë lufte" etj..... Pasi bën 6 vjet e 8 muaj burg, lirohet, më 28 dhjetor të vitit 1978. Më pas punon si punëtor i thjeshtë në një Fabrikë Gome në Durrës nga viti 1979 deri në 1987... Ishte koha kur regjisorin francez Domenico Dolemie vë në skenë në Francë dramën "Njolla të Murrme". Prej vitit 1998, kohë kur pëson një aksident, deri në ditën e vdekjes në 22 mars 2006, Minush Jero nuk do të dilte më nga shtëpia duke ndërprerë përfundimisht dhe shkrimet.

Kujtim Borici, Maksim Fejzullai



110 vite shtet shqiptar, rrugëtim, sfida, krenari kombëtare

Ekush më bukur se vargjet poetike, shpesh të derdhura në nota muzikore do e identifikonte këtë ndjenjë atdashedashurie, që me sa duket festat e 28-29 nëntorit e bëjnë të shpërfaqet dukshëm brenda trojeve shqiptare dhe përtej oqeanit, kudo ku shqiptarët jetojnë pa harruar identitetin e tyre, festojnë këtë ditë të bekuar.

28 nëntori i parë arbëror është ai i vitit 1443, kur Kryeheroi ynë, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu e ngriti për të parën herë në historinë e këtij kombi Flamurin me Shqiponjën Dykrenore dhe me yllin gjashtë-cepash në mes dy krenash, në kalanë e Krujës, ku valoi plot 25 vjet. Me po këtë forcë dhe vullnet u ngrit, pas 500 vitesh në Vlorën trime, nga "urtësia dhe mençuria" shqiptare, ati ynë Ismail Qemali, flamuri i kuq. Ky flamur, larë me gjakun e mijëra shqiptarëve.

Në të shohim qëndrimin e patundur dhe burrëror të atyre ushtarëve fisnikë që i ka udhëhequr atyre luftërave të rrepta, jo për sulme por për mbrojtje.

Në të shikojmë jetën e së ardhmes së këtij kombi, që u dergj shekujsh nën plaflin e robërisë, por kurrë i mundur.

110 vjet më parë, Ismail Qemali deklaroi: "Prej sot e shpallim Shqipërinë shtet të lirë e të pavarur".

Sot jetojmë të lirë, në tokën që amanet na lanë të parët. Dhe ne, ua trashëgojmë këtë pasuri të paçmueshme brezave të rinj, si një thesar, për të cilin duhet të kujdesen si për dritën e syve.

Gëzuar Shqipe, ditën më të bukur, ditën e lirisë, si më të shenjtën ndjenjë atdhetarie!

Atdhe, të ndiej edhe në kokrrën e rërës së detit,

Edhe në thërrimen e padukshme të nektarit,

Edhe në pikën e kaltër të vesës së mëngjesit,

Edhe në plisin e vlagët të ugarit.

Atdhe, të ndiej edhe në zhurmën e rrapit të lashtë,

Edhe në fijen e brishtë të barit,

Edhe në qerpikët si kallëza gruri të vashës,

Edhe në vijat e ballit të ushtarit.

Atdhe, të ndiej në çdo qelizë të indit të tokës sime,

E në çdo molekulë të ujërave që më lajnë,

E në çdo fërfërimë ere e frymë suferine,

E në çdo copë qielli që malet mbi kokë e mbajnë.

Atdhe, të ndiej në bulat e djersës së ndershme,

Të ndiej në tingujt e këngëve dhe isot e gjata,

Të ndiej në gurët dhe gdhendjet e hershme,

Të ndiej në lulet e qëndismave të grave të ngrata.

Atdhe, të ndiej në avullin e bukës së magjeve,

Të ndiej në shtigjet e dhive dhe rrugët e makinave,

Të ndiej në shijen e hidhur të tymit të oxhaqeve,

Të ndiej në tërbimin dhe dhimbjen e trimave.

Atdhe, të ndiej në hatullat e zemrës dhe shpirtit,

Të ndiej në zulmën pa cak të rinisë,

Të ndiej në qëndresën e plakjes sime si plakja e

Krishtit,

Të ndiej në gjësimin e madh të historisë.

Atdhe, ku të të ndiej, nëse një ndjenjë qenia ime

do të ketë,

Të them të të ndiej edhe në lëngun e hirit

Atje ku s'ka lëng e s'ka jetë?

Të them se të ndiej edhe në botën reale krejt të

vërtetë.

(Dritëro Agolli)



“110 VJET FORCA TË ARMATOSURA - SË BASHKU PËR PAQEN”

300 ARTISTË NGA ORKESTRA SIMFONIKE E FA-së, KORI I FA-së, BANDA E USHTRISË SHQIPTARE DHE BANDAT E USHTRIVE TË KOSOVËS DHE VENDEVE TË NATO-s, NGA SHBA-ja, BRITANIA E MADHE, FRANCA, ITALIA, GREQIA, MAQEDONIA E VERIUT, KROACIA DHE SLLOVENIA, SI EDHE SOLISTËT E MIRËNJOHUR: EVA GOLEMI, KASTRIOT TUSHA, YLBER GJINI, ARMANDO LIKA DHE RAMONA TULLUMANI, MË DATËN 3 DHJETOR, DO TË PERFORMOJNË NË PALLATIN E KONGRESEVE.

